

**QENDRA E TRAJNIMIT TË
ADMINISTRATËS TATIMORE DHE
DOGANORE**

**RAPORT VJETOR
2022**




Tabela e Përmbajtjes

Qëllimi:	3
Objektivat:.....	3
Përmbledhje	4
Organizimi dhe Metodologjia	7
Programet e Trajnimit 2022	7
Aktivite Trajnuese Administrata Doganore.....	9
<i>Trajnime të punonjësve të rinj.....</i>	<i>9</i>
<i>Testimi për punonjësit e rinj.....</i>	<i>18</i>
<i>Trajnime të punonjësve vazhdues.....</i>	<i>20</i>
<i>Trajnime të nivelit drejtues</i>	<i>36</i>
Aktivite Trajnuese Administrata Tatimore	40
<i>Trajnime të punonjësve të rinj “Nëpunës civilë në periudhë prove”</i>	<i>40</i>
<i>Testimi për punonjësit e rinj.....</i>	<i>55</i>
<i>Trajnime të punonjësve të rinj në periudhë prove me Kod Pune</i>	<i>56</i>
<i>Testimi për punonjësit me Kod Pune</i>	<i>70</i>
<i>Trajnime të punonjësve vazhdues të Administratës Tatimore.....</i>	<i>71</i>
<i>Trajnime për nivelin drejtues të Administratës Tatimore</i>	<i>96</i>
Programi i Hetimit Tatimor.....	105
<i>Testimi për punonjësit e Hetimit Tatimor</i>	<i>116</i>
Bashkëpunimi Shqipëri- Kosovë	117
Aneks I: Statistika me të dhënat për trajnimet me administratën doganore	119
Aneks II: Statistika me të dhënat për trajnimet me administratën tatimore.....	145
Aneks III: Statistika me të dhënat për trajnimet me Hetimin Tatimor	157
Aneks IV: Statistika përmbledhëse për trajnimet me administratën tatimore dhe doganore.....	163
Aneks V: Statistikat e Formularëve të Vlerësimit të Sadisfaksionit nga ana e Pjesëmarrësve...	165
Aneks VI: Statistikat e Realizimeve nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse.....	166
Aneks VII: Statistikat e Realizimeve nga Sektori i Financës	168

QËLLIMI

Arritja e objektivave të institucionit në funksion të zhvillimit të kapaciteteve, duke i orientuar të trajnuarit në kuptimin e përgjegjësisë të tyre teknike, profesionale në zbatim të legjislacionit fiskal.

OBJEKTIVAT

Krijimi i njohurive të reja dhe zgjerimi i njohurive ekzistuese rreth sistemit fiskal dhe ligjor në përgjithësi ,nëpërmjet trajnimeve, duke krijuar mundësinë e shkëmbimit të njohurive mes kategorive të ndryshme pjesmarrese të punonjësve të Administratës Tatimore dhe Doganore, si dhe aftësimin e tyre praktik dhe teorik.

Organizimi i procesit të edukimit në fushën fiskale duke pasur në fokus arritjen e objektivave të përgjithshëm strategjike.

Organizimi i trajnimeve në mënyrë efektive dhe efçente duke mbajtur një kosto sa më të ulët por duke bërë të mundur zhvillimin cilësor të mësimdhënies.

Orientimi i trajnerëve dhe organizimi i workshopeve drejt seminarëve praktike duke zbatuar parimet e reja të mësimdhënies për të rriturit.

Reformimi i kuadrit ligjor dhe proceseve të punës së Qendrës.

PËRMBLEDHJE

1. **Qendra** e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore gjatë vitit 2022 është fokusuar në:

•	Trajnimin fillestar- me punonjësit e rinj;
•	Trajnimin Vazhdues;
•	Trajnimin me nivelin Drejtues;
•	Trajnimin me strukturat e Hetimit tatimor.

2. **Qendra** ka reformuar kuadrin ligjor si më poshtë:

•	U miratua VKM e re e Qendrës Nr. 602, datë 14.09.2022.
•	U draftuan kurrikula të reja.
•	U draftuan detyrat dhe rregullat sipas kuadrit të ri ligjor, si rregullore e brendshme dhe ajo e trajnimit.
•	U hartua struktura e re organizative me funksionet shtesë të trajnerëve të brendshëm.

3. **Trajnimi** ka përfshirë çështje bazë dhe specifike që lidhen me detyrat e ushtruara dhe ndryshimet ligjore të fushës fiskale. Pjesë të programit ishin tema trajnimi që përfshijnë dhe çështje aktuale dhe sensitive për administratën, siç është mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta për informim, antikorrupsioni si dhe trajnime specifike me strukturë programi të hartuar në përputhje me nevojat dhe aftësitë për t'u krijuar tek punonjësit e hetimit tatimor.

Trajnimi është dhënë për punonjës të rinj e për nivelin vazhdues, në funksion të zhvillimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Përzgjedhja e temave të trajnimit u mbështet në kërkesat e administratave fiskale, në bazë të identifikimit që ato i bëjnë nevojave për trajnim në tema dhe njerëz, si dhe në sugjerimet e pjesëmarrësve dhe të trajnerëve.

4. U **miratuan** programet e trajnimit të:

<ul style="list-style-type: none"> • Administratës tatimore për 4 kategori pjesëmarrësish (të rinj, vazhdues, drejtues, punonjës të hetimit tatimor), në total 75 tema trajnimi.
<ul style="list-style-type: none"> • Administratës doganore për 3 kategori pjesëmarrësish (të rinj, vazhdues, drejtues) në total 42 tema trajnimi.
<ul style="list-style-type: none"> • Administratave tatimore dhe doganore 117 tema në total.

	Miratuar Tema	Zhvilluar Tema	Realizimi
Administrata Doganore	56	56	100%
Administrata Tatimore	42	42	100%
Hetimi Tatimor	19	19	100%
TOTALI	117	117	100%

5. **Pjesëmarrës** në trajnime të administratës tatimore dhe doganore 2218 punonjës në total.

<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrës në trajnime nga administratata tatimore ishin 1083 punonjës.
<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrës ne trajnime nga administratata doganore ishin 1088 punonjës.
<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrës në trajnime nga strukturat e hetimit tatimor ishin 47 punonjës.

6. **Numri total** i orëve të trajnimit është 1794 orë për të dy administratat.

<ul style="list-style-type: none"> • Numri total i orëve të trajnimit të administratës tatimore- 876 orë.
<ul style="list-style-type: none"> • Numri total i orëve të trajnimit të administratës doganore- 654 orë.
<ul style="list-style-type: none"> • Numri total i orëve të trajnimit të hetimit tatimor- 264 orë.

7. **Numri total** i trajnerëve të angazhuar për vitin 2022 është 45.

<ul style="list-style-type: none"> • Numri total i trajnerëve të angazhuar në trajnimet e administratës tatimore është 23.
<ul style="list-style-type: none"> • Numri total i trajnerëve të angazhuar në trajnimet e administratës doganore është 22.

Këta trajnerë kanë zhvilluar më shumë se një temë trajnimi, në varësi të fushës së tyre të ekspertizës.

8. Vlerësimi nga pjesëmarrësit.

<ul style="list-style-type: none">• Numri total i pjesëmarrësve që morën pjesë në vlerësim: 2934.
<ul style="list-style-type: none">• Trajnimet vlerësuar:<ul style="list-style-type: none">➤ 2818 ose 96.1% e pjesëmarrësve: shumë mirë➤ 98 ose 3.3% e pjesëmarrësve: mirë➤ 12 ose 0.4 % e pjesëmarrësve: mjaftueshëm➤ 6 ose 0.2% e pjesëmarrësve: dobët
<ul style="list-style-type: none">• Trajnerët vlerësuar:<ul style="list-style-type: none">➤ 2758 ose 95% e pjesëmarrësve: shumë mirë➤ 123 ose 4.2% e pjesëmarrësve: mirë➤ 20 ose 0.7% e pjesëmarrësve: mjaftueshëm➤ 5 ose 0.1% e pjesëmarrësve: dobët

9. **U hartuan** si mjet për organizimin e trajnimeve: Kalendarët e Trajnimeve të nevojshëm për organizimin e aktiviteteve në rajone të ndryshme, tema dhe trajnerë.

10. **Qendra** i ka planifikuar veprimtaritë e saj bazuar në filozofinë e zhvillimit ose përmirësimit profesional gjatë të punuarit të cilësive profesionale që kanë të bëjnë me efektivitetin në punë si dhe të cilësive profesionale që kanë të bëjnë me detyrat e përditshme të vendit të punës.

Punonjësve të tatimeve dhe doganave ju është dhënë mundësia e zhvillimit profesional pa pagesë gjatë trajnimeve të përgatitura nga një nivel i lartë profesional trajnerësh gjerësisht në lidhje me filozofinë, përmbajtjen dhe formatin e eksperiencave të të mësuarit.

11. **Qendra** përdori metodat profesionale të edukimit profesional të tilla si:

Diskutime të rasteve praktike - me qëllim që pjesëmarrësit të vihen në rolin e vendim marrësit që përballet me një problem. Çdo seminar është shoqëruar me një hapësirë dedikuar rasteve praktike për ta bërë akoma më të prekshëm çdo problematikë sidomos duke pasur parasysh faktin që Qendra bën trajnimin e punonjësve të rinj të cilët nuk kanë eksperiencë.

Përdorim i trajnerëve nga rradhët e metodistëve ose stafit drejtues të organeve fiskale- dhe atyre të specializuara me qëllim përmirësimin e kompetencave të pjesëmarrësve në një fushë specifike, nëpërmjet demonstrimit të procesit të observimit, reflektimit dhe veprimit.

Diskutim të çështjeve praktike të hasura nga vetë pjesëmarrësit- me qëllim përmirësimin e praktikës profesionale, nëpërmjet angazhimit në ndarjen e çështjeve që shqetësojnë, me njëri tjetrin si dhe mësimin me kolegët me të cilët kanë të njëjtin objektiv për të arritur.

Leksione studimore - me qëllim që të zgjidhen dilemat lidhur me mënyrën e leximit dhe interpretimit të neneve të veçanta të ligjeve fiskale.

Testime – për të skanuar shkallën e njohurive që zotërojnë, njohurive që marrin dhe për të vlerësuar nevojat e mëtejshme për trajnim specifik.

ORGANIZIMI DHE METODOLOGJIA

Orientimi i trajnerëve dhe organizimi i workshopeve ka qenë i orientuar drejt seminarëve praktike duke zbatuar parimet e reja të mësimdhënies për të rriturit.

Trajnimet janë zhvilluar në sallë. Trajnimet janë zhvilluar në 3 rajone për administratën tatimore dhe në 5 degë doganore për administratën doganore, duke mundësuar jo vetëm organizimin e trajnimit, por dërgimin e trajnimit tek pjesëmarrësi, për të pasur sa më shumë përfitim nga të trajnuarit dhe përdorim efikas të kohës së tyre.

Trajnerët përveç rasteve praktike janë orientuar drejt shpjegimit të rasteve konkrete nga praktika e punës, duke ia bërë më të prekshme leksionin pjesëmarrësve.

PROGRAMET E TRAJNIMIT 2022

Janë hartuar dhe miratuar me Vendimin nr.1 datë 28.01.2022 të Bordit të Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, Vendimit nr.2, datë 05.05.2022 dhe Vendimit nr.3, datë 19.12.2022 programet e trajnimit si më poshtë:

Administrata tatimore: 3 Programe trajnimi

- Programi i Trajnimit për punonjësit e rinj me 18 Tema,
- Programi i Trajnimit për nivelin drejtues me 10 Tema,
- Programi i Trajnimit për nivelin vazhdues me 28 Tema

Administrata doganore: 3 Programe trajnimi

- Programi i Trajnimit për punonjësit e rinj me 11 Tema,
- Programi i Trajnimit për nivelin drejtues me 5 Tema,
- Programi i Trajnimit për nivelin vazhdues me 26 Tema.

Administrata Tatimore: Programi i Hetimit Tatimor

- Programi i Trajnimit për inspektorët hetimor me 19 Tema.

Në zbatim të programeve të miratuara janë hartuar kalendarët përkatës dhe përfunduar aktiviteti trajnues.

Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve:

- Koordinohet midis institucioneve në lidhje me pjesëmarrësit në këto trajnime.
- Komunikohet me trajnerët në lidhje me metodologjinë që përdoret në trajnimet në sallë si dhe në lidhje me materialet e prezantimit dhe dokumentat shoqërues për secilin trajnim.
- Dërgohen kalendarët përkatës të programeve të trajnimit.
- Zhvillohen seminaret në sallë/fizikisht.
- Dërgohen materialet e trajnimeve për pjesëmarrësit si dhe u plotësohen formularët e vlerësimit për trajnimin.

AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA DOGANORE

Trajnime të punonjësve të rinj

AKTIVITETI I

"Nëpunësi civil, etika, konflikti i interesit. Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta për informim."

Për punonjësit e rinj dhe ata në periudhë prove të Administratës Doganore, 27 punonjës të rinj, të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave specifike doganore, respektivisht specialiste dhe doganiere nga Drejtoria e Antikontrabandës, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Drejtoria Antitrafikut, si edhe punonjës nga Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Si është ndërtuar kodi i etikës së Doganave;
- Si bëhet zbatimi i kodit të etikës;
- Cilat quhen shkelje të kodit të etikës;
- Masa konkrete të dhëna ndër vite mbi shkeljet e kodit të etikës;
- Njohja me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Njohja me atë që quhet informacion konfidencial;
- Njohja me ligjin për të drejtën e informimit;
- Roli dhe detyrat e koordinatorit të të drejtës për informim.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me ligjin për nëpunësin civil, kodin e etikës të administratës doganore dhe të drejtën për informim, mbështetur edhe në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Po ashtu u dhanë shembuj konkretë edhe të rasteve të shkeljes së kodit të etikës dhe fillimit të procedimit disiplinor për këtë shkak, për të cilin u përmend edhe fakti që përgjatë vitit 2021 për shkelje të kodit të etikës kishin filluar 126 procedime disiplinore për punonjësit e administratës doganore.

AKTIVITETI II

"Akciza. Garantimi dhe lëvizja e mallrave të akcizës. Pullat fiskale, administrimit dhe monitorimi. Përrjashtimet nga akciza, limitet e pataksueshme në import. Magazinat fiskale, lëvizja në pezullim i mallrave të akcizës."

Për punonjësit e rinj dhe ata në periudhë prove të Administratës Doganore, 29 punonjës të rinj të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave specifike doganore, respektivisht specialist dhe doganier nga Drejtoria e Antikontrabandës, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Drejtoria Antitrafikut, si edhe punonjës nga Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Njohja me kuadrin ligjor për akcizën në RSH;
- Pse duhet akciza dhe cilat janë mallrat që prek ajo;
- Krahasim i shkurtër mes ndryshimeve në legjislacionin e akcizës ndërmjet Shqipëri dhe BE;
- Kur lind detyrimi i akcizës;
- Si planifikohet programi i kontrollit;
- Çfarë janë magazinat fiskale.

Objektivi i këtij trajnimi: trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me ligjin për akcizën në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë trajtim të detajuar mbi mallrat që prek ligji, mallrat që nuk janë pjesë e ligjit dhe mënyrën e kontrollit për mallrat që janë subjekt i akcizës, për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Po ashtu u dhanë shembuj konkretë të mallrave specifike që janë subjekt i akcizës, duke treguar edhe mënyrat që përdorin të tjerët për t’ju shmangur akcizës. Kjo u bë me qëllim që punonjësit e rinj të jenë të vëmendshëm dhe vigjilentë gjatë punës së tyre, në mënyrë që ta kryejnë atë më profesionalizmin më të lartë.

AKTIVITETI III

“TVSH (Çfarë është TVSH, TVSH në import, përjashtimet, skemat e veçanta, vlera e tatueshme, etj). Taksat nacionale. Ligji i procedurave.”

Për: punonjësit e rinj dhe ata në periudhë prove të Administratës Doganore, 27 punonjës të rinj të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave specifike doganore, respektivisht specialist dhe doganier nga Drejtoria e Antikontrabandës, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Drejtoria Antitrafikut, si edhe punonjës nga Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Njohja me kuadrin ligjor të ligjit për TVSH;
- Ndryshimet e reja në ligj- fiskalizimi;
- Aplikimi i TVSH për mallrat në regjim doganor;
- Njohja me ligjin e procedurave tatimore;

- Sqarimi i taksave kombëtare, vlerat e tyre dhe organet mbledhëse.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me ligjin për TVSH në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë trajtim të detajuar mbi atë çfarë është TVSH-ja, kur lind dhe si mbledhet. Gjithashtu pjesë e trajnimit ishte edhe ligji i procedurave tatimore, për të cilin u krijuar një panoramë e përgjithshme në mënyrë që punonjësit e sistemit doganor të jenë të njohur edhe me aspektin tatimor. Në fund u trajtuan edhe llojet e taksave nacionale në Shqipëri, si edhe kush janë autoritetet mbledhëse të tyre. Po ashtu u dhanë shembuj të problematikave që lidhen kur për të njëjtin mall hyn në lojë edhe sistemi doganor, edhe sistemi tatimor, duke marrë në shqyrtim edhe aneksa konkrete të subjekteve në këtë aspekt.

AKTIVITETI IV

“Përdorimi i programit ASYCUDA WORLD, SEED, LIMS.”

Për: punonjësit e rinj dhe ata në periudhë prove të Administratës Doganore, 27 punonjës të rinj të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave specifike doganore, respektivisht specialist dhe doganier nga Drejtoria e Antikontrabandës, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Drejtoria Antitrafikut, si edhe punonjës nga Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Çfarë është programi ASYCUDA WORLD;
- Cilat janë lehtësitë që programi i ofron doganierit;
- Mënyrë konkrete e përdorimit të tij (ushtrim praktik);
- Cilat janë modulet e Asycudas;
- Çfarë është dokumenti administrative i vetëm (DAV) dhe si bëhet kanalizimi i tij;
- Cilat janë opsionet kryesore në brendi të programit Asycuda;
- Njohja me progamin Lims;
- Njohja me SEED.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me programin e automatizuar të doganës Asycuda Eorld dhe mënyrat e përdorjes së tij. Gjatë leksionit u shpjegua i gjithë procesi i futjes në sistem të mallrave sëbashku me plotësimin e të dhënave për çdo kategoritë që programi kërkon. Më pas u shpjegua programi Lims dhe Seed, në pika të përgjithshme, në mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit të rrisnin njohuritë e tyre rreth programeve të automatizuara që përdor sistemi doganor shqiptar.

AKTIVITETI V

“Trafikimit i veprave të Artit. Cash (Parandalimi i Pastrimit të parave). Lëndët Radioaktive.”

Për punonjësit e rinj dhe ata në periudhë prove të Administratës Doganore, 26 punonjës të rinj të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave specifike doganore, respektivisht specialist dhe doganier nga Drejtoria e Antikontrabandës, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Drejtoria Antitrafikut, si edhe punonjës nga Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Si është e organizuar Drejtoria e Antitrafikut pranë DPD;
- Cilat lëndë radioaktive dhe roli i punonjësve të doganave në pikasjen e tyre;
- Si bëhet inspektimi për këto lëndë dhe cilat janë paisjet që përdoren;
- Cilat janë rreziqet që vijnë nga rrezatimi dhe procesi i reagimit ndaj tyre;
- Çfarë është kontrolli në vijën e dytë;
- Si qarkullojnë veprat e artit/trashëgimisë kulturore në mënyrë kontrabandë;
- Sfidat në zbulimin e tyre dhe procedurat që duhen ndjekur;
- Njohja më formularin e deklarimit të parave cash dhe sendeve më vlerë në doganë
- Mënyrat e marrjes në pyetje kur ka dyshim për kalim të shumave të mëdha parash cash dhe sendeve me vlerë në mënyrë ilegale;
- Gjjobat dhe dënimet në raste të tilla.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me parandalimin e trafikimit të veprave të artit dhe atyre të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë mënyrën e identifikimit të tyre dhe gjithë hapat e komunikimit nga doganieri deri tek Drejtoria e Antitrafikut. Gjithashtu u prek edhe pjesa e kalimit të lëndëve radioaktive nëpër dogana, për të cilat pjesëmarrësit u njohën me llojet e këtyre lëndëve dhe mënyrat sesi sistemi shqiptar doganor përpiqet ti parandalojë. Po ashtu të pranishmit u trajnuan edhe në lidhje me mënyrën e parandalimit të kalimit ilegal të parave cash në hyrje dhe në dalje të pikave doganore.

AKTIVITETI VI

“Rëndësia e Vlerësimit Doganor të mallrave. Metodat e Vlerësimit Doganor të mallrave.”

Për punonjësit e rinj dhe ata në periudhë prove të Administratës Doganore, 26 punonjës të rinj të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave specifike doganore, respektivisht specialist dhe doganier nga Drejtoria e Antikontrabandës, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e

Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Drejtoria Antitrafikut, si edhe punonjës nga Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Vlerësimi doganor i mallrave;
- Metodot e vlerësimit doganor;
- Auditimi i vlerës doganore;
- Ri-faturimi.

Objektivi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të kenë përvetësuar konceptet bazë të metodologjisë së vlerësimit të mallrave, metodat e vlerësimit, përdorimin e tyre, rast pas rasti, sipas kushteve dhe rrethanave, të japin zgjidhje konkrete për vlerësimin e mallrave, bazuar në një vendimmarrje të argumentuar.

AKTIVITETI VII

“Rregullat e Origjinës së mallrave. Marrëveshjet dhe kumulimi. Provat e origjinës.”

Për punonjësit e rinj dhe ata në periudhë prove të Administratës Doganore, 24 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganiere nga Drejtoria e Antikontrabandës, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Drejtoria Antitrafikut, si edhe punonjës nga Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Rregullat e Origjinës së mallrave;
- Marrëveshjet dhe kumulimi;
- Provat e origjinës.

Objektivi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të kenë përvetësuar konceptet bazë të rregullave të origjinës së mallrave, marrëveshjet ndërkombëtare, kumulimin e origjinës së mallrave, si dhe provat e origjinës.

AKTIVITETI VIII

“Tarifa doganore dhe klasifikimi i mallrave. Përjashtimet nga taksa doganore në import. Informacioni Tarifor Detyrues dhe Trajtimi Tarifor Favorizues. Taksat e tjera në import dhe eksport të shërbimit doganor.”

Për punonjësit e rinj dhe ata në periudhë prove të Administratës Doganore, 21 pjesëmarrës, respektivisht specialiste dhe doganiere nga Drejtoria e Antikontrabandës, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Menaxhimit të

Burimeve Njerezore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Drejtoria Antitrafikut, si edhe punonjës nga Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Tarifa doganore dhe klasifikimi i mallrave;
- Përfashtimet nga taksa doganore në import;
- Informacioni Tarifor Detyrues dhe Trajtimi Tarifor Favorizues;
- Taksat e tjera në import dhe eksport të shërbimit doganor.

Objektivi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të kenë përvetësuar konceptet bazë të tarifës doganore, klasifikimit tarifor, përfashtimeve nga taksat doganore në import, informacionin tarifor detyrues, taksat e tjera në import.

AKTIVITETI IX

“Borxhi Doganor. Akti administrativ. Shkeljet doganore.”

Për punonjësit e rinj dhe ata në periudhë prove të Administratës Doganore, 23 pjesëmarrës, respektivisht specialiste dhe doganiere nga Drejtoria e Antikontrabandës, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Drejtoria Antitrafikut, si edhe punonjës nga Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Njohja me konceptin e borxhit doganor;
- Çfarë është borxhi i akcizës;
- Çfarë cilësohet detyrim i papaguar;
- Kur lind borxhi doganor/borxhi i akcizës;
- Si kryhet mbledhje e borxhit dhe sekuestrimi;
- Si bëhet vendimmarrja për mbledhjen e borxhit;
- Kush quhet debitor dhe cili është përgjegjësi që paguan borxhin kur malli ka kaluar nëpër disa pronarë;
- Cilat janë gjobat që vendosen dhe si llogariten ato.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me mënyrën dhe shkaqet kur lind borxhi doganor/borxhi akcizës dhe cilat janë kushtet kur një detyrim konsiderohet borxh. Po ashtu pjesëmarrësit u trajnuan në lidhje me metodologjinë që ndiqet që nga konstatimi i lindjes së borxhit, deri në vendimmarrje dhe mbledhje të tij. Po ashtu të trajnuarit mësuan mbi raste konkrete kur kishtë lindur borxhi doganor dhe cilat ishin hapat që ishin ndjekur për situatën e dhënë.

AKTIVITETI X

“Masat Antikorrupsion dhe sjellja e duhur e punonjësve të administratës doganore.”

Për punonjësit e rinj dhe ata në periudhë prove të Administratës Doganore, 7 pjesëmarrës, respektivisht specialiste dhe doganiere nga Drejtoria e Antikontrabandës, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Drejtoria Antitrafikut, si edhe punonjës nga Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Njohja me konceptin e korrupsionit;
- Në sa forma njihet korrupsioni sot;
- Si është përpjekur të zvogëlohet ky fenomen;
- Njohja me konceptin e sinjalizuesit;
- Raste praktike.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptin e antikorrupsionit dhe shpjegimit mbi drejtorinë e antikorrupsionit që vepron brenda DPD. U trajtuan të gjitha format e korrupsionit dhe masat parandaluese për secilën prej tyre. Po ashtu u trajtuan edhe disa nga ndëshimet që jepen në rast të vërtetimit të veprës së korrupsionit. Në fund për pjesëmarrësit u trajtuan edhe shembuj konkretë, duke ngacmuar edhe diskutimet mes të pranishmëve mbi mënyrën sesi do të vepronin nëse do të gjendeshin përpara situatave të caktuar.

AKTIVITETI XI

“Regjimet doganore. RPA, RLP. Deklarimi, përfaqësimi. Deklarata doganore. Garancitë doganore.”

Për punonjësit e rinj dhe ata në periudhë prove të Administratës Doganore, 21 pjesëmarrës, respektivisht specialiste dhe doganiere nga Drejtoria e Antikontrabandës, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Drejtoria Antitrafikut, si edhe punonjës nga Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Regjimet doganore. RPA, RLP.
- Deklarimi, përfaqësimi.
- Deklarata doganore.
- Garancitë doganore.

Objektivi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të kenë përvetësuar konceptet bazë të regjimeve doganore, llojet e regjimeve, deklaratat doganore.

Foto nga trajnimet me punonjësit e rinj të administratës doganore:



Testimi për punonjësit e rinj

Në përfundim të programit të trajnimit për punonjësit e rinj në periudhë prove të administratës doganore, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore organizoi testimin mbi vlerësimin e njohurive të fituara nga pjesëmarrësit. Testimi u zhvillua në datën 16 dhe 25 mars 2022.

Evidenca

Vlerësimi	Dogana
Mjaftueshëm (51-64 pikë)	2
Mirë (65-79 pikë)	15
Shumë Mirë (80-100pikë)	10
Totali	27

Foto nga Testimi



AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA DOGANORE

Trajnime të punonjësve vazhdues

AKTIVITETI I

“Akciza. Trajnim për kontrollet dokumentare dhe në subjekt akcize për mallrat e akcizës. Mbikqyrja e subjekteve të regjimeve dhe akcizës. Mallrat e akcizës dhe llogaritja e kësaj takse për këto produkte. Plotësimi i DSHA-së.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, 57 pjesëmarrës në total në 5 degët doganore në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore Tiranë me 15 pjesëmarrës, në degën doganore Fier me 13 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 8 pjesëmarrës, në degën doganore Korçë me 10 pjesëmarrës dhe në degën doganore Sarandë me 11 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Njohja me kuadrin ligjor për akcizën në RSH;
- Pse duhet akciza dhe cilat janë mallrat që prek ajo;
- Konceptet kryesore që lidhen me akcizën;
- Kur lind detyrimi i akcizës;
- Si planifikohet programi i kontrollit;
- Çfarë janë magazinat fiskale;
- Analizimi dhe menaxhimi i riskut;
- Verifikimi dhe llojet e tij;
- Dokumentet shoqëruese të mallrave.

Objektivi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të kenë përvetësuar konceptet bazë të akcizës. Të mësohen me ndryshimet që ka pësuar ndër vite legjislacioni për akcizën në RSH, si edhe njohja me gjithë dokumentacionin e nevojshëm për identifikimin e mallrave të akcizës, por edhe për rimbursim.

AKTIVITETI II

“Hyrja-Dalja e mallrave, ndryshimet në legjislacion dhe në Asycuda.Politikat e Vlerësimit Doganor. Statusi i mallrave.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore me 57 pjesëmarrës në total në 5 degë doganore në pozicionet në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore Tiranë me 9 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 11 pjesëmarrës, në degën doganore Korçë me 21 pjesëmarrës, në degën doganore Sarandë me 10 pjesëmarrës dhe në degën doganore Vlorë me 6 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Regjimet e posaçme;
- Magazina Doganore;
- Deklarata doganore standarte;
- Përdorimi i zhdoganimit të centralizuar;
- Deklarimi i thjeshtuar;
- Përdorimi përfundimtar end-use.

Objektivi i këtij trajnimi përvetësimi i koncepteve bazë të legjislacionit mbi hyrjen dhe daljen e mallrave nga pikat doganore në Republikën e Shqipërisë, si edhe me ndryshimet e fundit që pasur legjislacioni doganor në këtë aspekt.

AKTIVITETI III

“Procedurat e mostrimit. Procedura e marrjës së mostrave laboratorike. Kompetencat e laboratorëve testues dhe kalibrues (Për Standartin 17025:2017). Metodat e reja analitike për analizimin e mallrave dhe njohjen e praktikave me të mira laboratorike.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, ku more pjesë 53 pjesëmarrës në total në të 5 degët doganore, në pozicionet në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore Tiranë me 9 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 14 pjesëmarrës, në degën doganore Sarandë me 8 pjesëmarrës, në degën doganore Korçë me 16 pjesëmarrës dhe në degën doganore Vlorë me 6 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Çfarë janë mostrat laboratorike;
- Cilat janë udhëzimet ligjore mbi kryejn e analizave të mostrave;
- Cilat janë materialet fizike të domosdoshme për mbledhjen e mostrave;
- Si bëhet komunikimi doganier-subjekt-laborator doganor;
- Cilat janë manualët që duhet të ndiqen kur merren mostra;

- Si operohet nëpërmjet sistemit LIMS.

Objektivi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të njiheshin me rregullat që ndiqeshin për mallrat që kanë nevojë për analiza laboratorike, të cilat mund të kryhen si në laboratorin doganor, ashtu edhe në vende të tjera për analiza komplekse. Të trajnuarit u njohën me mekanizmat dhe format kryesore të marrjes së mostrave, si edhe mjetet kryesore që përdoren në varësi të llojit të mallit që do të merret për analizë.

AKTIVITETI IV

“Kodi i Etikës dhe konflikti i interesit në administratën doganore shqiptare. Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta për informim.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, ku more pjesë 57 pjesëmarrës në total në të 5 degët doganore, në pozicionet në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore Shkodër me 13 pjesëmarrës, në degën doganore Tiranë me 8 pjesëmarrës, në degën doganore Sarandë me 15 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 10 pjesëmarrës dhe në degën doganore Korçë me 11 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Si është ndërtuar kodi i etikës së Doganave;
- Si bëhet zbatimi i kodit të etikës;
- Cilat quhen shkelje të kodit të etikës;
- Masa konkrete të dhëna ndër vite mbi shkeljet e kodit të etikës;
- Njohja me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Njohja me atë që quhet informacion konfidencial;
- Njohja me ligjin për të drejtën e informimit;
- Roli dhe detyrat e koordinatorit të të drejtës për informim.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me ligjin për nëpunësin civil, kodin e etikës të administratës doganore dhe të drejtën për informim, mbështetur edhe në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre.

AKTIVITETI V

“Rregullat e origjinës preferenciale. Rregullat e Origjinës së Konventës PEM dhe Marreveshjes me MB; Rregullat tranzitore të Origjinës së Konventës PEM; Kumulimi i origjinës.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, ku more pjesë 38 pjesëmarrës në total, në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore Tiranë

me 14 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 11 pjesëmarrës, në degën doganore Korçë me 13 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Si klasifikohen mallrat sipas natyrës dhe origjinës së tyre;
- Çfarë parashikon Konventa PEM dhe detyrimet ndaj saj;
- Cilat janë rregullat në fuqi për mallrat që kalojnë në formë tranziti.

Objektivi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të njiheshin me rregullat që parashikon konventa PEM, në të cilën edhe vendi ynë është pjesë, mbi origjinën e mallrave, mënyrën e përcaktimit të origjinës edhe kur malli është transit, si edhe detyrimet që lindin të qenurit pjesë e konventës.

AKTIVITETI VI

“Përshkrimet e punës dhe monitorimi i performancës.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, ku more pjesë 58 pjesëmarrës në total, në pozicionet specialist dhe doganier, në degën doganore Tiranë me 11 pjesëmarrës, në degën doganore Sarandë me 12 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 11 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 11 dhe në degën doganore Korçë me 13 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Roli i burimeve njerëzore në përshkrimet e punës;
- Rregullat dhe mekanizmat që nëpunësit zbatojnë gjatë përditshmërisë, pasi njihen me përshkrimin e punës;
- Si realizohet vlerësimi periodik i punonjësve;
- Pse është i rëndësishëm vlerësimi pozitiv për nëpunësit;
- Si ndikon vlerësimi negativ tek punonjësit në marrëdhënien e tyre të punës.

Objektivi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të njiheshin me rregullat dhe detyrimet që vijnë pas leximit të përshkrimit të punës, si edhe me mënyrën sesi punonjësit vlerësohen periodikisht, duke pasur parasysh edhe pasojat në ras të vlerësimeve negative.

AKTIVITETI VII

“Vlerësimi Doganor. Metodat e Vlerësimi.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, ku more pjesë 42 pjesëmarrës në total, në pozicionet specialist dhe doganier, në degën doganore Tiranë me 5 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 9 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 8

pjesëmarrës, në degën doganore Sarandë me 8 pjesëmarrës dhe në degën doganore Korçë me 12 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Rëndësinë e vlerësimit doganor të mallrave;
- Metodën e vlerësimit;
- Databaza e vlerësimit;
- E drejta e ankimit.

Objekti i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me politikat e vlerësimit doganor dhe metodat që ndiqen nga ADSH në lidhje me këto procedura, duke përfshirë trajtim të detajuar, për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Grupi pjesëmarrës përbëhet nga punonjës vazhdues të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave specifike doganore. Po ashtu u dhanë shembuj konkretë.

AKTIVITETI VIII

“Kodi Doganor dhe Kodi i Procedurave Administrative. Kundravajtjet administrative. Ankimi administrativ, format e ankimit administrativ ndaj akteve të administratës doganore dhe kushtëzimet ligjore. Apelimet. Aktet dhe veprimet administrative të favorshme.”

Trajnimi u zhvillua për punonjës të vazhdues të Administratës Doganore, ku more pjesë 44 pjesëmarrës në total, në pozicionet specialist dhe doganier, në degën doganore Tiranë me 8 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 10 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 6 pjesëmarrës, në degën doganore Sarandë me 10 pjesëmarrës dhe në degën doganore Korçë me 10 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Ndryshimet e Kodit Doganor;
- Kundravajtjet administrative;
- Ankimi administrativ, format e ankimit administrativ ndaj akteve të administratës doganore dhe kushtëzimet ligjore;
- Apelimet;
- Aktet dhe veprimet administrative të favorshme.

Objekti i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me kodin doganor të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë trajtim të detajuar mbi procedurat administrative në raste konkrete, për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave

të tyre. Grupi pjesmarrës përbëhet nga punonjës vazhdues të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave specifike doganore. Po ashtu u dhanë shembuj konkretë të mallrave specifike.

AKTIVITETI IX

“Regjimet ekonomike (Përpunim Aktiv-Pasiv) RPA, RLP. Zonat e lira doganore.”

Trajnimi u zhvillua për punonjës të vazhdues të Administratës Doganore, ku more pjesë 48 pjesëmarrës në total, në pozicionet specialist dhe doganier, në degën doganore Tiranë me 9 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 8 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 10 pjesëmarrës, në degën doganore Sarandë me 9 pjesëmarrës dhe në degën doganore Korçë me 12 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Hyrje-daljen e mallrave;
- Magazinimi i përkohshëm;
- Regjimet Doganore;
- Regjime të posaçme;
- Përdorimi përfundimtar end-use.

Objekti i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me ligjin e procedurave doganore dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë fushë. Grupi pjesmarrës përbëhet nga punonjës vazhdues të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave specifike doganore. Po ashtu u dhanë shembuj konkretë të mallrave specifike.

AKTIVITETI X

“Procedurat doganore. Dispozita të zbatueshme për mallrat që hyjnë dhe dalin nga dhe në territorin doganor. Operatori ekonomik i autorizuar. Përfaqësimi. Dokumentet e përfaqësimit. Praktika doganore. Raste praktike.”

Trajnimi u zhvillua për punonjës të vazhdues të Administratës Doganore, ku more pjesë 54 pjesëmarrës në total, në pozicionet specialist dhe doganier, në degën doganore Tiranë me 8 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 9 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 13 pjesëmarrës, në degën doganore Sarandë me 12 pjesëmarrës dhe në degën doganore Korçë me 12 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Mënyrën e deklarimit para hyrjes së mallrave;
- Deklarimi përmbledhës i hyrjes;
- Deklarimi përmbledhës i daljes;
- Mënyra e magazinimit të përkohshëm;

- Regjimet doganore/ regjimet e posaçme;
- Transiti i jashtëm/ transiti i brendshëm;
- Zonat e lira;
- Përpunimi aktiv.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me procedurat e ndryshme doganore që lindin gjatë regjimeve të ndryshme doganore apo rasteve specifike, të cilat kanë nevojë për zgjidhje procedurale, për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Grupi pjesëmarrës përbëhet nga punonjës vazhdues të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave specifike doganore. Po ashtu u dhanë shembuj konkretë të mallrave specifike.

AKTIVITETI XI

“Shkeljet në fushën e doganore. Kundërvajtja dhe kontrabanda. Kundërvajtjet në fushën doganore, kazuse. Kontrabanda, kuptimi i veprës penale të kontrabandës, elementet e veprës së kontrabandës, zgjidhja administrative. Dispozita penale për kontrabandën. Padia civile në procesin penal, zgjidhja administrative e kontrabandës. Raste praktike dhe zgjidhje e kazuseve për shkeljet doganore.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, ku more pjesë 42 pjesëmarrës në total, në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore Tiranë me 6 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 8 pjesëmarrës, në degën doganore Korçë me 12 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 6 pjesëmarrës, në degën doganore Sarandë me 10 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Shkeljet doganore;
- Kundërvajtja dhe kontrabanda;
- Raste praktike;

Objektivi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të njiheshin me shkeljet në fushën doganore, kontrabandën dhe kundërvajtjet, bazën ligjore, raste konkrete të zgjidhura nga administrata doganore, duke përfshirë trajtim të detajuar, për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Grupi pjesëmarrës përbëhet nga punonjës vazhdues të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave doganore. Po ashtu u dhanë shembuj konkretë.

AKTIVITETI XII

“Mbi sigurinë kibernetike në Administratën Doganore Shqiptare.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, ku more pjesë 51 pjesëmarrës në total, në pozicionet specialist dhe doganier, në degën doganore Tiranë me 10 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 10 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 8 pjesëmarrës dhe në degën doganore Korçë me 11 pjesëmarrës, në degën doganore Sarandë me 12 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Çfarë është siguria kibernetike;
- Bazat e sigurisë kibernetike;
- Siguria e Sistemeve të Informacionit;
- Kërcënimet për sigurinë kibernetike;
- Legjislacioni në Shqipëri, strukturat përkatëse;

Objekti i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me bazën ligjore të sigurisë kibernetike, kërcënimet kibernetike, masat mbrojtëse, strukturat përkatëse, duke përfshirë trajtim të detajuar, për të përmituar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Grupi pjesëmarrës përbëhet nga punonjës vazhdues të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave doganore. Po ashtu u dhanë shembuj konkretë.

AKTIVITETI XIII

“Metodat e mbledhjes së informacionit të inteligjencës operative dhe përpunimit të tij.

Shkëmbimi i informacionit midis sektorëve të inteligjencës nga administratat homologe.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, ku more pjesë 42 pjesëmarrës në total, në pozicionet specialist dhe doganier, në degën doganore Tiranë me 7 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 10 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 5 pjesëmarrës dhe në degën doganore Korçë me 12 pjesëmarrës, në degën doganore Sarandë me 8 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Organizimi;
- Baza ligjore;
- Bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar;
- Shkëmbimi i informacionit me homologët;
- Praktikat më të mira;

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me metodat e shkëmbimit të inteligjencës, bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar dhe shkëmbimin e informacionit me homologët, duke përfshirë trajtim të detajuar, për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Grupi pjesmarrës përbëhet nga punonjës vazhdues të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave specifike doganore. Po ashtu u dhanë shembuj konkretë.

AKTIVITETI XIV

“E drejta për informim, parimet kryesore, roli dhe detyrat e Autoritetit Publik, administrata transparente nëpërmjet instrumentit të Programit të Transparences, roli i koordinorit.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, ku morën pjesë 25 pjesëmarrës në total, në pozicionet specialist, shef sektori, auditees, koordinator në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Informacion publik;
- Programe transparence;
- Koordinator për të drejtën e informimit;
- Kundravajtjet administrative;

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur të drejtën për informim, kufizimet e të drejtës për informim, programet e transparencës duke përfshirë trajtim të detajuar, për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Ky trajnim u zhvillua në bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Po ashtu u dhanë shembuj konkretë të rasteve të paraqitura për administratën doganore.

AKTIVITETI XV

“Platforma Click/ Modulet online WCO.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, ku more pjesë 56 pjesëmarrës në total, në pozicionet specialist dhe doganier, në degën doganore Tiranë me 13 pjesëmarrës, në degën doganore Morinë me 12 pjesëmarrës, në degën doganore Berat me 10 pjesëmarrës dhe në degën doganore Qafë Thanë me 10 pjesëmarrës, në degën doganore Kakavijë me 11 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Platforma
- Mundësitë
- Logimi
- Përdorimi

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me përdorimin e Platformës Click, krijimi i userave, kurset që ofrohen, duke përfshirë trajtim të detajuar, për të mundësuar aksesimin e tyre në platformë. Grupi pjesmarrës përbëhet nga punonjës vazhdues të administratës doganore si dhe gjithashtu në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës, "Mbi Krijimin e Qendrës së Përbashkët Trajnuese", pjesmarrës në trajnim ishin edhe doganier nga Dogana e Kosovës.

AKTIVITETI XVI

“Kontrolli Doganor. Kontrolli i mallrave dhe mbikqyrja doganore. Kontrolli aposterior.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, ku more pjesë 48 pjesëmarrës në total, në pozicionet specialist dhe doganier, në degën doganore Tiranë me 9 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 12 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 5 pjesëmarrës dhe në degën doganore Korçë me 12 pjesëmarrës, në degën doganore Kakavijë me 10 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Kontrolli doganor;
- Procedurat e kontrollit;
- Raste praktike.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me procedurat e kontrollit doganor, llojet e kontrollit, duke përfshirë trajtim të detajuar, për të mundësuar zbatimin sa më efektiv të detyrave të tyre. Grupi pjesmarrës përbëhet nga punonjës vazhdues të administratës doganore që merren me kontrollin doganor

AKTIVITETI XVII

“Borxhi doganor. Fazat e lindjes dhe shuarjes të borxhit doganor. Titulli ekzekutiv dhe ekzekutimi i tij nëpërmjet masave detyruese si sekuestrimi dhe konfiskimi; praktika administrative dhe gjyqësore në lidhje me rikuperimin forcërisht të borxhit doganor. Vendimet e favorshme në lidhje me përjashtimin doganor. Raste praktike dhe kazuse në lidhje me lindjen, pagesën e detyrimeve doganore, shuarjen, rimbursimin dhe parashkrimin.”

